



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 116, datë 06.06.2019**

**PËR**

**MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE, NDAJ VLERËSUESIT TË DËMEVE NË  
SIGURIME Z. ILIR ROBAJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 235, dhe nenit 152 pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E :**

BSHS, me shkresën nr. 1192 prot. datë 18.02.2019, ka depozituar në Autoritet disa akte vlerësimi të hartuar nga ky vlerësues dëmsh, me kërkesën për rishikimin e tyre nga Autoriteti për shkak se janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Z. Ilir Robaj, vlerësues i pavarur i dëmeve në sigurime, licencuar me nr. 138 datë 27.12.2016, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime ka kryer akt vlerësimi në disa variante për një ngjarje sigurimi.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit konstatohet se:

Në variantin e parë për rastin me paaftësi të përhershme të z. Mark Doçi vlerësimi është bërë sipas Rregullores 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, ndërsa në variantin e dytë dëmi moral dhe ekzistencial është llogaritur si dy figura të veçanta, ku vlera për secilën është marrë ajo që në fakt sipas Rregullores 53, datë 25.06.2009, i takonte të ishte për të dyja figurat së bashku.

Në takimin e organizuar pranë zyrave të AMF-së, në datën 09.04.2019, midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Zbatshmërisë dhe vlerësuesit të pavarur z. Ilir Robaj, nga ana e këtij të fundit është pretenduar se përllogaritja e dëmshpërblimit është kryer vetëm në një variant duke u bazuar në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar.

Pjesa e fundit e akt vlerësimit, që ka të bëj me dëmin moral dhe ekzistencial si figura të ndara më vete, është kryer në përgjigje të kërkesës së palës paditëse dhe nga eksperti nuk është deklaruar se përgjigjet e dhëna në gjykatë përbëjnë variant më vete.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

### **V E N D O S I:**

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet vlerësuasi i pavarur z. Ilir Robaj, si më poshtë:
  - i. Të kryejë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në përputhje me legjislacionin në fuqi në sigurime;
  - ii. Të bëjë vlerësime të paanshme duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 233, të Ligjit nr. 52/2014.
2. Përsëritja e shkeljeve të mësipërme, do të jetë objekt i masave të përshkallëzuara konform legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**